REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit: SP-02 — Nr.Prot / Broj.Prot / Prot.No: 2366-2/26

Nr. i faqeve / Broj.stranica / No.pages: -04- — Data / Datum / Date: 28/10/2026

PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary

DATË/A:	10.09.2026
REFERENC-Ë:	26/2366/MMPH
PËR/ZA/TO:	"HYDRO – LINE" SH.P.K. Mitrovicë Hidrocentrali gjenerues H3, me pajimet përcjellës, përgjatë lumit Bistrica Mitrovicë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 26/2366/MMPH te dt. 05.05.2026, të operatorit "HYDRO – LINE" SH.P.K. Mitrovicë, për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore me nr. 20/822/MEA, e lëshuar me dt. 22.03.2021.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, mbajtjes së debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore për operatorin "HYDRO – LINE" SH.P.K. Mitrovicë, për Hidrocentrali gjenerues H3, me pajimet përcjellës, përgjatë lumit Bistrica Mitrovicë; dhe
2. Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary

Nr.: 26/2366/MMPH
Datë: 10.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 17 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "HYDRO – LINE" SH.P.K. Mitrovicë, për Hidrocentrali gjenerues H3 me kapacitet 4.267MW, me pajimet përcjellës, përgjatë lumit Bistrica Mitrovicë i vazhdohet afati i Lejes Mjedisore.

2. Operatori obligohet:

2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
2.2. Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me Lejet Ujore për shfrytëzim të ujit, Ligjin e ujërave dhe aktet nen ligjore që derivojn nga ky Ligj;
2.3. Të respektohen hierarkia ujore në përputhje me Ligjin e ujërave, dhe akteve nen ligjore që derivojn nga ky Ligj;

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

2.4. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike, që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, po ashtu në rast të ndonjë aksidenti mjedisore të njoftoj MMPH-në;
2.5. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
2.6. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdim te Leje Mjedisore, vizitës në teren për verifikimin e kushteve mjedisore, mbajtjes së debatit publik me qytetar për operatorin "HYDRO - LINE" SH.P.K. Mitrovicë, është konstatuar se operatori për Hidrocentrali gjenerues H3 me kapacitet 4.267MW, me pajimet përcjellës, përgjatë lumit Bistrica Mitrovicë, Operatori i plotëson kriteret e parapara në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore dhe nenin 9 të Udhëzimit Adrninistrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim është nxjerrë, duke u bazuar edhe në dokumentacionin paraprak që ka prezantuar kompania:

- Memorandum mirëkuptimi me nr. 01 - 31 - 3167, të lëshuar me dt. 07.02.2013, i arritur ndërmjet komunës së Mitrovicës dhe kompanisë Hydro - Line, për ndërtimin e Hidrocentraleve në Lumin Bistricë dhe Lumenjtë për rreth;
- Vendim nga komuna e Mitrovicës me nr. 02/06 - 9536/6, të lëshuar nga komuna e Mitrovicës me dt. 25.04.2013, për shpalljen me prioritet të veçantë, zhvillimin e energjisë alternative në komunën e Mitrovicës;
- Pëlqim ndërtimin e HC (Lumi Bistrica) nga Instituti Arkeologjik i Kosovës me nr. 69 - 03, të lëshuar me dt. 25.03.2013;
- Pëlqim ndërtimin e HC (Lumi Bistrica) nga Instituti Arkeologjik i Kosovës me nr. 70- 03, të lëshuar me dt. 25.03.2013;
- Pëlqimin Mjedisor me Nr. 13/1284/2-ZSP-198/13, datë: 19.08.2013;
- Leje Ndërtimorë nga komuna e Mitrovicës me nr. 08 - 351-26423, të lëshuar me dt. 17.10.2013;
- Certifikatë mbi përdorimin e objektit nga Komuna e Mitrovicës me nr. 08-351/01-0009706/17, të lëshuar me dt. 13.02.2017;
- Shpjegim nga komuna me nr. Prot. 08- 351/02-52708/20, të lëshuar me dt. 21.09.2020, për përfshirjen e tubacionit brenda Lejes Ndërtimore me nr. Prot. 08-351-26423, të lëshuar me dt. 17.10.2013, dhe Certifikatës mbi përdorimin e objektit me nr. Prot. 08 - 351 / 01-0009706/17, të lëshuar me dt. 13.02.2017;
- Shpjegim nga komuna me nr. Prot. 08- 351/02-02752/21, të lëshuar me dt. 09.02.2021, për përfshirjen e tubacionit brenda Lejes Ndërtimore me nr. Prot. 08-

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

351-26423, të lëshuar me dt. 17.10.2013, dhe Certifikatës mbi përdorimin e objektit me nr. Prot. 08 – 351 / 01-0009706/17, të lëshuar me dt. 13.02.2017;

- Vendim- Leje Ujorë nga MEA, për shfrytëzim të ujit për HEC Albaniku 3, me nr. Prot. Nr. 3986/20 të lëshuar me dt. 13.11.2020, me afat te vlefshmërisë 20 vite;
- Vendimin e Lejes mjedisore paraprake me nr. 20/822/MEA, e lëshuar me dt. 22.03.2021.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Ky vazhdim i Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/